MIRATOI
KRYETARE E BASHKISË LUSHNJE
Eriselda SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJE

# RELACION

## NDËRTIMI I VARREZAVE TË REJA LAGJIA ÇLIRIMI , LUSHNJE

## PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM:

Realizimi i projektit është konceptuar të zhvillohet në disa faza. Faza e parë përfshin këto punime: Spostimi i rrugës Allprenaj; ndërtimi murit rrethues ballor; shtrimi sheshevë me çakull; shtrimi me beton i rrugëve të blloqeve; ndërtimi infrastuktures K.U.B.; mbjellje pemësh. Nivelimi dhe sistemimi i parcelave me punime gërmim\mbushje dherash, do të kryhet paraprakisht nga Ndërmarrja e Pasurisë Publike.

Skema e zhvillimit të projektit është simetrike ku në të përfshihen rrugë, gjelbërim, ndriçim parkim dhe ambjentet ndihmëse. Ndërtimi do të kryhet me blloqe të ndara me rrugë kryesore dhe sekondare si dhe do të kenë siperfaqe të gjelbëruara dhe pemë dekorative.




*1-planvendosja e varrezave të reja FAZA E PARË.*

Si pasojë e terrenit të pjerrët, zgjidhja është bërë me tarraca me tre këmbë shkallë nga një tarrace në tjetrën duke arritur disnivelet e terrenit, në drejtim tërthor dhe gjatësor, por dhe me rrugë me gjerësi 4 m parale me blloqet e varrezave.




*2-Prerja B'-B' .*

## KONCEPT-IDEJA:




*3-Diagrama e zhvillimit konceptual.*

## RELIEVI:

Porjekti shtrihet në terren kodrinor dhe relievit drejtpërdrejt përcakton formën e tij. Duke ju referuar të dhenave nga rilevimi, në profilin gjatësor, me largësi progresive 105m, pjerrësia e tokës është 2.43% dhe deri në largësinë progresive 228m ajo ritet në 6.3%.




*4-Planvendosja me izoipse (të treja fazat).*

## FASHAT:

Spostimi rrugës dhe respektimi i fashave apo distancave kryesore të rrethimit e brezit të gjelbëruar, i lënë hapsirë parkimit dhe shërbimeve të tjera ndihmëse.




*5-Plani i spostimit të rrugës kryesore.*

Rruga e propozuar spostohet 12m dhe parashikohet e gjerë 6m. Rrethimi me mur dhe kangjella e ndërthurur me brezin e gjelbëruar, lejon transparencën dhe krijimin e hapsirave të qeta e intime. Parkimi dhe shërbimet në hyrje kamuflohen e mbulohen nga pemët e larta dhe bimësia e shtuar.




*6-Plani i spostimit të rrugës kryesore.*




*7-Prerja e rrugës*




*8-Detaj rrethimi*

## SISTEMI RRUGOR – QARKULLIMI:

Qarkullimi në ambientet e varrezave, kryhet nëpërmjet rrugës 8m e cila lejon kalimin e njerëzve dhe automjeteve në të njëjtën kohë. Shpërndarja nëpër zonat e ndryshme bëhet me anë të rrugëve të shruara me beton. Pasazhe me shkallë, 4m në gjerësi, i dedikohet vizitorëve. Ato janë të pajisura me gjelberim në të dyja krahët.




*9-Plani i spostimit të rrugës kryesore (të treja fazat).*




*10-Prerja e rrugës dhe detaje.*

## KOMPOZIMI SHESHIT TË NDËRTIMIT DHE ZGJERIMI VARREZAVE:

Parcela bazë që është kompozuar me sipërfaqe rreth 900 m2, ku brenda saj përfshihen rrugicat e këmbësorëve, hapësirat ndërmjet varreve, si edhe gjelbërimi.




*11-Fragment planvendosja e parcelës tip.*

Largësia e varreve nga njëri-tjetri është mbajtur 0.6m. Varret janë parashikuar të vendosen në rreshta ku një rresht do të ketë 17 varre dhe ndërmjet rreshtave janë parashikuar rrugë kalimi, me gjerësi 0.6m dhe në çdo 2 rreshta një rrugicë kalimi me gjerësi 1.2m. Brenda parcelës do të mundësohet kalim komod edhe për personat me aftësi të kufizuara.




*12-Prerje parcela tip.*

## DIMENSIONET E VARREVE

Qivuri zhvillohet në një sipërfaqe me dimensione 80x220 dhe lartësi/ndhe brez. Mënyra e vendosjes së tyre është e drejtuar nga perëndimi. Në total janë 10204 varre.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE




13-Aksionometri varri solitar.




14-Detaj D.4 sistemimi e parcelës tip.

Duke marr parasysh numrin e vdekjeve në qytetin e Lushnjes (rreth 250 në vit) varrezat do të përdoren për 40 vitet e ardhshme.




15-Parametrat minimale.




16-Parametrat minimale




17- Varr solitar 1-10 vjeç.




18- Varr solitar deri 1 vjeç.

RENDERA 3D:



Punoi: Entjol Monka

Drejtoresha e Planifikimit

Mimoza Haxhiu